



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 07 qershor 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e procedurës së dhënies së licencës të transmetimit audio analoge”. (**Vendimi nr. 84 datë 07.06.2019**)
2. “Pranimin e kërkesës së shoqatës “Radio Maria”, licencuar për subjektin audio të komunitetit “Radio Maria”, për reduktimin e zonës së shërbimit nga “*Qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër*”, në “*Qarqet Lezhë, Shkodër, Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Vorë dhe Shijak*”. (**Vendimi nr. 85 datë 07.06.2019**)
3. “Miratimin e një ndryshimi në vendimin e AMA-s, nr. 202, datë 24.12.2018 “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2019”. (**Vendimi nr. 86 datë 07.06.2019**)
4. “Shprehjen kundër projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin e mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, pasi aktiviteti i shërbimeve të publikimeve elektronike bie jashtë fushës së veprimit të Autoritetit të Audiovizive. (**Vendimi nr. 87 datë 07.06.2019**)
5. “Ndëshkimin e shoqërisë “Focus Media Nesws” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “Tv News 24”, me sanksion gjobë në masën 150,000 lekë”. (**Vendimi nr. 88, datë 07.06.2019**)
6. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “3DS&AF Entertainment” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “TNT” dhe për subjektin audio “Best Radio” për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së subjektit.” (**Vendimi nr. 89, datë 07.06.2019**)
7. “Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti person fizik Orjana Cenko, për rishikimin e vendimit të AMA-s, nr. 71, datë 25.04.2019 “Për heqjen e licencës së subjektit person fizik Orjana Cenko, për subjektin audio privat “Radio Channel 7”. (**Vendimi nr. 90, datë 07.06.2019**)

8. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Arben Mërtiri, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Arten”. **(Vendimi nr. 91 datë 07.06.2019)**
9. “Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Beqaj Kabllor 2004” dhe shfuqizimin e vendimit për dënimin me gjobë nr. 12, datë 02.05.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga inspektorët e AMA-s, ndaj subjektit “Tv kabllor Beqaj”. **(Vendimi nr. 92 datë 07.06.2019)**
10. “Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Maqellara Tv kabllor” sh.p.k., dhe shfuqizimin e vendimit për dënimin me gjobë nr. 1, datë 10.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga inspektorët e AMA-s, ndaj subjektit “TV Kabllor Maqellara”. **(Vendimi nr. 93 datë 07.06.2019)**
11. “Rrëzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Elbasan Cable” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të vendimit për dënimin me gjobë nr. 6, datë 16.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga inspektorët e AMA-s, ndaj subjektit “Elbasan Cable”. **(Vendimi nr. 94 datë 07.06.2019)**
12. “Rrëzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Elion Boriçi dhe lënien në fuqi të vendimit për dënimin me gjobë nr. 3, datë 12.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga inspektorët e AMA-s, ndaj subjektit “**Tv kabllor Brado**”. **(Vendimi nr. 95 datë 07.06.2019)**

**Tiranë, 07 qershor 2019**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**